V E N D I M
Nr.248, datë 24.4.2003

PËR MIRATIMIN E NORMAVE TË PËRKOHSHME TË SHKARKIMEVE NË AJËR DHE ZBATIMIN E TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7 të ligjit nr.8897, datë 16.5.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e normave të përkohshme të shkarkimeve në ajër, sipas 6 anekseve që i bashkëlidhen këtij vendimi e që janë pjesë e tij.

2. Normat e përkohshme të shkarkimeve në ajër zbatohen vetëm nga subjektet, veprimtaritë ekzistuese të të cilave kanë një nivel teknik dhe teknologjik, i cili nuk lejon të zbatohen normat e shkarkimeve në ajër, të miratuara me vendimin nr.435, datë 12.9.2002, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë".

3. Këto subjekte, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, paraqesin në Ministrinë e Mjedisit programin e masave dhe afatet e zbatimit të normave të shkarkimeve në ajër.

4. Ministria e Mjedisit, në bazë të programeve të paraqitura, të vendosë kohën e zbatimit të normave të përkohshme, si dhe afatin kur subjekti do t'u nënshtrohet normave të shkarkimeve në ajër. Koha e zbatimit të normave të përkohshme nuk mund të jetë më shumë se 5 vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

5. Për subjektet, që nuk e paraqesin programin, afati për zbatimin e normave të përkohshme të shkarkimeve në ajër është 2 vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

ANEKS NR.1
LISTA E NDOTËSVE

Grupi 0. - Ndotësit bazë
Lëndë e ngurtë
Okside të squfurit
Okside të azotit
Oksidi i karbonit

Grupi 1

Nëngrupi 1. asbesti benzo (a) pireni 2-naftil amina berilliumi dhe komponimet e tij të shprehura si Be kadmiumi dhe komponimet e tij të shprehura si Cd dibenzoantracen	Nëngrupi 2. arseniku dhe komponimet e tij të shprehura si As komponimet e kromit 6 valent të shprehura si Cr kobalti dhe komponimet e tij të shprehura si Co nikeli dhe komponimet e tij të shprehura si Ni
Nëngrupi 3. akrilonitrili benzen 1,3-butadien epiklorhidrin	Nëngrupi 4. bifenilet e poliklorinuara dibenzofuranet e poliklorinuara dibenzodioxinat e poliklorinuara

oksid etileni (oksiran) hidrazinë oksid propileni klorur vinili	

Grupi 2

Nëngrupi 1. zhiva dhe komponimet e saj të shprehura si Hg taliumi dhe komponimet e tij të shprehura si Tl	Nëngrupi 2. seleniumi dhe komponimet e tij të shprehura si Se teluriumi dhe komponimet e tij të shprehura si Te
Nëngrupi 3. antimoni dhe komponimet e tij të shprehura si Sb kallaji dhe komponimet e tij të shprehura si Sn floruret të shprehura si F- kromi dhe komponimet e tij të shprehura si (me përjashtim të CrVI) Cr cianuret të shprehura si CN- mangani dhe komponimet e tij të shprehura si Mn bakri dhe komponimet e tij të shprehura si Cu plumbi dhe komponimet e tij të shprehura si Pb vanadi dhe komponimet e tij të shprehura si V zinku dhe komponimet e tij të shprehura si Zn	

Grupi 3

Nëngrupi 1. stibinë arsinë fosfinë fosgen klorur cianhidrik	Nëngrupi 2. bromi dhe komponimet e tij të të gazta shprehura si HBr fluori dhe komponimet e tij të të gazta shprehura si HF klori acidi/gazi cianhidrik sulfuri i hidrogjenit acidet e forta organikë të shprehura si H-
Nëngrupi 3. Amoniak Komponimet inorganike të gazta të klorit të shprehura si HCl	

Grupi 4

Nëngrupi 1 Aldehid acetik Aniline kloruri i benzenit dietil amine 1,2-dy kloretan 1,1-dy kloretilen dy metil amina etanol amine akrilati i etilit fenol aldehidi formik krezole acid akrilik acid formik merkaptane akrilati i metilit metil amine nitrobenzen nitrofenol nitrokrezol nitrotoluen piridine	Nëngrupi 2 Aldehidi benzoik aldehid butilik 1,4-dyklorbenzene etil benzeni furfural klorbenzene 2-kloropreni (2-klor-1,3-butadiene) 2-klorpropan isopropil benzeni acid acetik acetat metili metakrilati i metilit 1-metil naftalen 2-metil naftalen naftalen stiren toluen acetati i vinilit ksilen

sulfur karboni 1,1,2,2-tetrakloroetan tetrakloretilen tioeter o-toluidine (2-metil aniline) triklorometan trikloroetilen	
Nëngrupi 3. aceton alkooli alkilik dyfenil 2-butanon acetat butili eter dibutilik eter dietilik eter difenilik 1,2-dykloretilen dyklormetan eter dyisopropilik eter dimetilik acetat etili etilen glikol 4-hydroksil-4-etil-2-pentanon metil esteret eacidit benzoik 4-metil-2-pentanol N-metil pirrolidon olefina me përjashtim të 1,3- parafina me përjashtim të metanit	

ANEKS NR. 2

KATEGORIZIMI I DISA BURIMEVE TË ZGJEDHURA TË NDOTJES, NORMAT E SHKARKIMEVE, SHKALLA E LEJUESHME E ERRËSISË SË TYMIT DHE KUSHTET TEKNIKE TË VEPRIMIT TË BURIMEVE TË ZGJEDHURA TË NDOTJES

KATEGORIZIMI I DISA BURIMEVE TË ZGJEDHURA TË NDOTJES

Për qëllimet e këtij aneksi do të përdoren emërtimet e mëposhtme:

- kushte referimi A për normat e shkarkimeve që i referohen përqëndrimit të ndotësit përkatës në gaz të thatë në kushte normale (101.32 kPa, 0oC), që mund të shoqërohet nga përmbajtja referuese e substancave të tjera në gazin mbartës (zakonisht oksigjen);

- kushte referimi B për normat e shkarkimeve që i referohen përqëndrimit të ndotësit përkatës në gazin e njomë në kushte normale (101.32 kPa, 0oC), që mund të shoqërohet nga përmbajtja referuese e substancave të tjera në gazin mbartës (zakonisht oksigjen)

- kushte referimi C për normat e shkarkimeve që i referohen përqëndrimit të ndotësit përkatës në gazin e njomë në kushte normale veprimi.

1. INDUSTRIA E PRODHIMIT TË LËNDËVE TË DJEGSHME DHE TË ENERGJISË

1.1 Djegia e lëndëve të djegshme për përpunimin e naftës në impiante teknike që përmbajnë pajisje të palëvizshme me kapacitet termik më të madh se 0.2 MW (KPTHN – Ballsh, UPN – Fier)

1.1.1Furra me lëndë të djegshme të lëngët-mazut

Kapaciteti termik i instaluar (MW)	Norma e përkohshme e shkarkimeve në mg/m³, për	Rf. Përmbajtja e oksigjenit në %

	Lëndë e ngurtë (LN)	Dyoksid squfuri SO2	Okside azoti si NO2	Oksid karboni CO	Lëndë organike si Σ C	
> 0.2 - 20	200	8000	650	350	-	3

1.1.2 Furra me lëndë të djegshme të lëngët-solar

Kapaciteti termik i instaluar (MW)	Norma e përkohshme e shkarkimeve në mg/m³, për					Rf. Përmbajtja e oksigjenit në %
	Lëndë e ngurtë (LN)	Dyoksid squfuri SO2	Okside azoti si NO2	Oksid karboni CO	Lëndë organike si Σ C	
> 0.2 - 20	100	6000	300	200	-	3

1.1.3 Furra me lëndë të djegshme të lëngët - gaz

Kapaciteti termik i instaluar (MW)	Normat e shkarkimeve në mg/m³ për					Rf. Përmbajtja e oksigjenit në %
	Lëndë e ngurtë (LN)	Dyoksid squfuri SO2	Okside azoti si NO2	Oksid karboni CO	Lëndë organike si Σ C	
> 0.2 - 20	50	900	200	100	-	3

1.1.4Prodhimi i squfurit në KPTHN

Sasia e shkarkimit Nm³/orë	Normat e shkarkimeve në gr/m³ për					Rf. Përmbajtja e oksigjenit në %
	Lëndë e ngurtë (LN)	Dyoksid squfuri SO2	Sulfur hidrogjeni H2S	Oksid karboni CO	Lëndë organike si Σ C	
1500	0.2	34	15	0.2	-	3

1.1.5 Kollona e avarisë në impiantin e koksit KPTHN - Ballsh

Sasia e shkarkimit Nm³/24orë	Normat e shkarkimeve në gr/m³ për					Rf. Përmbajtja e oksigjenit në %
	Lëndë e ngurtë (LN)	Dyoksid squfuri SO2	Sulfur hidrogjeni H2S	Oksid karboni CO	Lëndë organike si Σ C	
300	0.2	84	15	0.2	-	3

1.2 Djegia e lëndëve të djegshme për prodhim energjie në impiante teknike që përmbajnë pajisje të palëvizshme me kapacitet termik më të madh se 0.5 MW (TEC-e)

1.2.1Furra me lëndë të djegshme të lëngët-mazut

Kapaciteti termik i instaluar (MW)	Norma e përkohshme e shkarkimeve në mg/m³, për					Rf. Përmbajtja e oksigjenit në %
	Lëndë e ngurtë (LN)	Dyoksid squfuri SO2	Okside azoti si NO2	Oksid karboni CO	Lëndë organike si Σ C	
> 50	200	8000	650	350	-	3

2. PRODHIMI INDUSTRIAL DHE PËRPUNIMI I METALEVE

Kërkesat për projektimin, pajisjen dhe/ose veprimin e proceseve teknologjike

Për procese me veprim të ndërprerë me shkarkime të ndryshueshme duhet të vendosen normat e shkarkimeve për parametrat mesatarë të proceseve teknike.

Të gjitha shkarkimet e ndotësve të ngurtë në ajër nga burimet e specifikuara në kapitullin 2 duhet të minimizohen me anë të zgjerimit dhe largimit të pluhurave ose mbylljes hermetike nëse kjo është e mundshme teknikisht.

2.1 Prodhimi i çelikut në furrë elektrike me hark (FEH)

Kapaciteti i FEH në ton	Norma e përkohshme e shkarkimeve në mg/m³, për					Kushte referimi
	Lëndë e ngurtë (LN)	Dyoksid squfuri SO2	Okside azoti si NO2	Oksid karboni CO	Lëndë organike si Σ C	
20~50 t	100	1700	600	1800	-	C

2.2 Furrat e ngrohjes për trajtimet termike për impiantet e petëzimit dhe deformime të tjera plastike.

Kapaciteti termik i instaluar MW	Norma e përkohshme e shkarkimeve në mg/m³, për					Rf. Përmbajtja e oksigjenit në %
	Lëndë e ngurtë (LN)	Dyoksid squfuri SO2	Okside azoti si NO2	Oksid karboni CO	Lëndë organike si Σ C	
>0.2 ~ 50	100	1700	450	300	-	3

2.3 Impiante për prodhimin e ferrolidhjeve me anë të proceseve elektrotermike ose pirometalurgjike

Kapaciteti termik i instaluar MW	Norma e përkohshme e shkarkimeve në mg/m³, për	Kushte referimi

	Lëndë e ngurtë (LN)	Dyoksid squfuri SO2	Okside azoti si NO2	Oksid karboni CO	Lëndë organike si Σ C	
>0.2 ~ 50	140	-	400	1600	-	C

Prodhim bakër blistër në furra Water-Xhaket ose Reverber

Kapaciteti termik i instaluar MW	Norma e përkohshme e shkarkimeve në mg/m³, për					Kushte referimi
	Lëndë e ngurtë (LN)	Dyoksid squfuri SO2	Okside azoti si NO2	Oksid karboni CO	Lëndë organike si Σ C	
30 - 40	1000	30000	-	3000	-	C

3. PRODHIMI I PRODUKTEVE MINERALE JOMETALORE

(burimet e mëdha të ndotjes me përjashtim të atyre të shënuara në tabelë)

3.1 Guroret dhe impiantet e përpunimit të tyre, transportimi i gurëve, procesi dhe funksionimi - Gurët natyrorë dhe artificialë (burime mesatare ndotjeje)

Të gjitha vendet dhe proceset në të cilat ndotësit e ngurtë emetohen në ajër duhet të pajisen sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji ose spërkatjeje, heqje pluhurash ose sisteme spërkatjeje.

3.2 Prodhimi i gëlqeres

	Norma e përkohshme e shkarkimeve në mg/m³, për	Rf. Përmbajtja e oksigjenit në %

	Lëndë e ngurtë (LN)	Dyoksid squfuri SO2	Okside azoti si NO2	Oksid karboni CO	Lëndë organike si Σ C	
	100	800	1800	250	-	C

3.3 Prodhimi i çimentos

	Norma e përkohshme e shkarkimeve në mg/m³, për	Rf. Përmbajtja e oksigjenit në %

	Lëndë e ngurtë (LN)	Dyoksid squfuri SO2	Okside azoti si NO2	Oksid karboni CO	Lëndë organike si Σ C	
	100	800	1500	250	1.5	C

4. INDUSTRIA KIMIKE

(burime të mëdha ndotjeje me përjashtim të atyre të shkruara në tekst)

4.1 Stacionet e shërbimit dhe linjat e transportimit të lëndëve të djegshme për motorra automjetesh (burime mesatare ndotje)

Për pompimin e substancave me trysni avujsh më të madhe se 1.32 kPa në temperaturë 20oC

(për shembull gjatë shkarkimit nga tanket e lëvizshme ose gjatë ngarkimit të tyre nga tanket e magazinimit) duhen krijuar kushtet për grumbullimin, riqarkullimin dhe eliminimin e substancave të tilla me efikasitet jo më të vogël se 99% dhe:

duhet të përdoren pompa që ndalojnë shpëtimin e substancave të pompuara për

shembull me bllokim mekanik;

b) duhet që të paktën një linjë operimi për ngarkimin e tankeve të lëvizshme duhet të pajiset për të ngarkuar tanket e lëvizshme të ngarkimit nga fundi;

c) linja veprimi për mbushjen e tankeve të lëvizshme nga maja duhet të safeguarded

sigurohen në mënyrë që gjatë ngarkimit, fundi i tubit mbushës të qëndrojë në fundin e tankut të lëvizshëm.

Vlerat e përgjithshme të normave të shkarkimit janë njëlloj të vlefshme për t'u zbatuar edhe për linja të tilla.

4.2 Prodhimi i substancave inorganike

4.2.1 Prodhimi i plehrave kimike industriale

Vlerat e përgjithshme të normave të shkarkimit janë njëlloj të vlefshme për t'u zbatuar për amoniakun, okside dhe komponime të tjera të azotit, komponime të squfurit, komponime të fosforit dhe lëndë të ngurta.

Për superfosfatin:

Substanca të ngurta (LN)	50 mg/m3
Dyoksid squfuri (SO2)	1200 Nm3/orë

5. TRAJTIMI I MBETJEVE

5.1 Burimet e mëdha të ndotjes'

5.1.1 Linja për djegien e mbetjeve të rrezikshme dhe spitalore

Norma shkarkimi [mg/m3] për					Përmbajtje referuese e oksigjenit O2 ë%]	Kushte referimi
Substanca të ngurta (LN)	Dyoksid squfuri SO2	Okside azoti si NO2	Oksid karboni CO	Të tjera		
1	2	3	4	5	6	7
10	300	500	150	2 1) 10 2)	11	A

Shënim:

1. HF (Florur hidrogjeni)
2. HCl (Klorur hidrogjeni)

5.2 Burimet mesatare të ndotjes

5.2.1. Impiantet e trajtimit të ujërave të përdorura

Pajisjet me kapacitet për 500 ose më shumë banorë ekuivalent ose të projektuara për vënien në punë të teknologjive që prodhojnë ndotje uji.

Substancat me erë nuk duhet të përmbahen në ajrin e shkarkuar në përqëndrime që mund të përbëjnë shqetësim për banorët.

5.2.2 Impiantet e kompostimit

Pajisje të destinuara për kompostim industrial

Substancat me erë nuk duhet të përmbahen në ajrin e shkarkuar në përqëndrime që mund të përbëjnë shqetësim për banorët.

5.2.3 Impiantet për djegien e drurit të përdorur, mbeturinat prej letre dhe mbeturina të tjera të ngjashme

Norma shkarkimi [mg/m3] për					Përmbajtje referuese e oksigjenit O2 [%]	Kushte referimi
Substanca të ngurta (LN)	Dyoksid squfuri SO2	Okside azoti si NO2	Oksid karboni CO	të tjera		

1	2	3	4	5	6	7
50	300	500	250	5 1) 50 2)	11	A

a) Ndalohen të digjen mbeturinat në impiante me fuqi kalorifike më të ulët se 350 kw

6. TË TJERA

(burime mesatare ndotjeje me përjashtimet e shënuara në tekst)

6.1 Strukturat dhe linjat për mbarështimin e kafshëve shtëpiake

Komplekset me zënie mesatare vjetore mbi 500 kokë gjedhë, mbi 5000 kokë derra dhe mbi 50 000 kokë shpendë duhet të konsiderohen burime të mëdha ndotjeje.

Komplekset me zënie mesatare vjetore ndërmjet 180 dhe 499 kokë gjedhë, 500-4999 kokë derra dhe mbi 1000-49 999 kokë shpendë duhet të konsiderohen burime mesatare ndotjeje.

Vlerat e përgjithshme të normave të shkarkimit janë njëlloj të vlefshme për t'u zbatuar për amoniakun. Substancat me erë nuk duhet të përmbahen në ajrin e shkarkuar në përqëndrime që do të përbënin shqetësime për banorët. Shkarkimet e substancave organike të shprehura në karbon total nuk duhet të kalojnë vlerat e mëposhtme:

a) jashtëqitje në të ngrohtë për prurje më të mëdha se 50 gram/orë50 mg/m3

b) jashtëqitje në të ftohtë për prurje 50-300 gram/orë120 mg/m3

c) jashtëqitje në të ftohtë për prurje më të mëdha se 300 gram/orë50 mg/m3

6.2 Komplekse të kujdesit shëndetësor për kafshët

Linja për grumbullimin dhe përpunimin e trupave të kafshëve dhe prodhimin e materialeve ushqyese, plehrave dhe yndyrnave nga produkte anësore të jashtëqitjeve të kafshëve, për shembull kocka, qime, lëkurë, brirë, gjaku etj.

Substancat me erë nuk duhet të përmbahen në ajrin e shkarkuar në përqëndrime që do të përbënin shqetësime për banorët.

6.3 Përdorimi i bojërave

Linjat dhe teknologjia e projektuar për përdorimin e materialeve të lëngëta dhe të pluhërizuara (për shembull me anë të spërkatjes, ngjyerjes, bojatisjes, shkëlqimit etj.) si bojëra ndaj lëndëve të ndryshme (të tilla si metale, lëndë plastike, lëkurë, dru etj.), me përjashtim të letrës dhe kartonit.

Kërkesa për ndërtimin, pajisjen dhe vënien në punë të proceseve teknologjike

1. Për pakësimin e shkarkimeve të substancave organike duhet të përdoren të gjitha mjetet teknikisht të mundshme veçanërisht përdorimin e teknologjive me përmbajtje të ulët solventi të veshjeve, zbatimin e proceseve me efikasitet të lartë etj.

2. Për vendosjen e normave të shkarkimit, linja të tilla duhen konsideruar njësi teknike e një sistemi teknik veshjeje.

3. Për përdorimin e bojërave duhet të jenë të vlefshme kushtet e referimit C.

6.3.1 Përdorimi i bojërave me harxhim të veshjeve më të mëdha se 5 kg në ditë, deri në një harxhim vjetor 10 t (burime mesatare ndotjeje)

Norma e shkarkimit duhet të jetë vlera e vlerës orare të normës së shkarkimit për lëndët volatile ku hyjnë solventët, të shprehur si karbon total 100 mg/m3 .

6.3.2 Dyqanet e bojërave me harxhim të veshjeve më të mëdha se 5 kg në ditë, deri në një harxhim vjetor më të madh se10 t (burime të mëdha ndotje).

Përqëndrimi në masë i ndotësve të ngurtë në gazet që dalin nga kutitë e thata ose zonat e përdorimit të veshjeve nuk duhet të kalojë 3 mg/m3.

6.3.3 Të tjera dyqane bojërash me harxhim vjetor veshje më pak se 250 t

Norma e shkarkimit duhet t'i përgjigjet shkarkimit specifik të prodhimit të substancave volatile, të shprehura si karbon i përgjithshëm në një sasi prej:

- 120 mg/m3 për aplikimin e veshjeve me efekt metalizues,
- 60 mg/m3 për aplikimin e veshjeve të tjera.

Në të njëtën kohë, përqëndrimi në masë i lëndëve volatile në ajrin e mbetur që del nga zona e aplikimit të veshjes, i shprehur si karbon i përgjithshëm, nuk duhet të kalojë vlerën 50 mg/m3.

6.4 Përpunimi i drurit

Përpunimi industrial i drurit (për shembull mullinj), prodhimi i mobiljeve, karton ndërtimi, përveç se operacioneve të bluarjes, ruajtjes në magazina

Ndotës	Normë shkarkimi [mg/m3]	Shkarkimi prodhimi specifik [kg/t]	Kushte referimi	Shënim
1	2	3	4	5
Lëndë të ngurta	70 1) 20 2)		C	3)

Shënim:

1. Për të gjitha operacionet teknike, përveç pastrimit me zumpara,

2. për pastrimin me zumpara në prodhimin e skelave të ndërtmit dhe mobiljeve,

3. norma shkarkimi për lëndët organike në prodhimin e kompensatave dhe në prodhimin e kartonit të ndërtimit dhe mobiljeve duhet të vendosen në mënyrë të ndarë duke marrë në konsideratë kushtet e veprimit.

6.5 Industria poligrafike

Linjat dhe teknologjitë e destinuara për aplikimin e printimit të bojës në letër, karton ose materiale të prodhuara prej tyre ose përdorimi i zbatimeve të ngjashme teknike dhe materiale

Komponimi ndotës	Norma e shkarkimit [mg/m3]	Shkarkimi i prodhimit specifik [kg/t]	Kushte referimi	Shënim
1	2	3	4	5
komponime organike Lëndë të ngurta	50 2) 3	-	C	1)

Shënim:

Në gazet që dalin nga zona të zbatimit dhe tharjes së bojërave të printimit

të shprehura si karbon i përgjithshëm.

6.6 Heqja e grasos prej metaleve dhe përbërësve elektrikë që përdorin solventë organikë të klorinuar.

Në gazet që dalin nga teknologjitë dhe linjat degreasing që përdorin një vëllim solventësh të kloruar organikë më të madh se 5 litra dhe për një prurje mase të avujve të tyre më të madh se 500 g/h, përqëndrimi në masë i avujve të këtyre solventëve në dalje të pajisjes nxjerrëse të gazit në ajër duhet të mos e kalojë vlerën 100 mg/m3 për kushtet C të referimit.

6.7 Pastrimi i pëlhurave, lëkurave dhe peliçeve me solventë organikë

Për vlerat e përqëndrimit duhet të jenë të vlefshme kushtet C të referimit.

Përqëndrimi në masë i avujve të solventëve të klorinuar në gazet që dalin nga kutitë tharëse dhe nga mjediset e punës, për një masë fluksi më të madh se 500 g/h, duhet të mos kalojë vlerën 250 mg/m3.

Shkarkimet specifike të prodhimit, të përcaktuara nga mesatarja mujore, nuk duhet të kalojë 30g solventë për kg pëlhurë, ose lëkurë.

Çdo linjë duhet të pajiset me pajisje për kapjen e avujve të përqëndruar.

Në pastrimin e rrobave, lëkurëve dhe peliçeve me benzinë, naftë 150/200 ose solventë alkanikë të ngjashëm, përqëndrimi në masë në gazin e karrierës nuk duhet të kalojë vlerën 6 g/m3.

Shkarkimet specifike të prodhimit, të gjetura nga mesatarja mujore nuk duhet të kalojnë vlerën 150 g solventë për kg pëlhurë lëkurë dhe gëzofë të pastruar.

7. PROCESET E PAKLASIFIKUARA

Në këtë aneks nuk specifikohen ato procese për të cilat janë njëlloj të vlefshme normat e përgjithshme të shkarkimeve.

Në këtë rast, klasifikimi i burimeve dhe detyrimet e lidhura me to, burojnë nga pikat e këtij aneksi, veçanërisht § 6 dhe § 5 par. 2.

B. VLERAT E PËRGJITHSHME TË NORMAVE TË SHKARKIMEVE TË GAZTA DHE SHKALLËS SË LEJUAR TË ERRËSISË SË TYMIT

Të gjitha normat e shkarkimeve të këtij aneksi janë të vlefshme për përqëndrimet në gazin e

lëngët, (+) në kushte normale (të presionit prej 101.32 kPa dhe të temperaturës prej 0oC).

0. Norma shkarkimesh për substancat ndotëse të grupit 0-Ndotësit bazë

a) Normat e shkarkimeve për ndotës të ngurtë

Përqëndrimi në masë i ndotësve të ngurtë për një prurje në masë të barabartë ose më të ulët se 1 kg/h, përqëndrimi në masë i ndotësve të ngurtë në gazin e oxhakut të mos kalojë vlerën 250 mg/m³. Për një prurje në masë të ndotësve të ngurtë më të madhe se 1 kg/h, përqëndrimi në masë i ndotësve të ngurtë në gazin e oxhakut nuk duhet ta kalojë vlerën 200 mg/m³.

b) Normat e shkarkimeve për dyoksid squfurin

Për një prurje në masë dyoksid squfuri më të madhe se 25 kg/h përqëndrimi në masë i dyoksidit të squfurit në gazin e oxhakut të mos e kalojë vlerën 8500 mg/m³.

c) Normat e shkarkimeve për oksidet e azotit

Për një prurje në masë të oksidit të azotit më të madhe se 25 kg/h, përqëndrimi në masë i oksidit të azotit në gazin e oxhakut të mos e kalojë vlerën 650 mg/m³.Vlera e prurjes në masë dhe përqëndrimi në masë i oksideve të azotit duhet të shprehet si dyoksid azoti.

d) Normat e shkarkimeve për monoksid karboni

Për një masë fluksi të monoksidit të karbonit më të madhe se 25 kg/h, përqëndrimi në masë i monoksidit të karbonit në gazin e oxhakut të mos e kalojë vlerën 350mg/ m³

1. Normat e shkarkimeve për shkallën e lejuar të errësisë së tymit

Norma më e madhe e lejueshme e errësisë së tymit duhet të jetë veti optike e tymit që prodhohet nga adsorbimi në vijën e tymit që largohet nga oxhaku. Kjo sasi duhet të shprehet në njësi sipas shkallës Ringelmann në vijën e tymit (nivelet 0-5). Errësia e tymit mund gjithashtu të shprehet me shkallën Bacharach (0-9) ose duke matur opacitetin (%), i cili duhet të matet në flue të tymit.

Norma më e madhe e lejueshme e errësisë së tymit të shkarkuar nga proceset e djegies duhet të jepen nga këto norma të përgjithshme shkarkimesh :

a) Në djegien e lëndëve të djegshme, tymi i shkarkuar nuk duhet të jetë më i errët se

niveli 2 për matje dhe vlerësime sipas shkallës Ringelmann, ndërsa sipas vlerës së matur të opacitetit nuk duhet të jetë më e madhe se 40%. Gjatë periudhës së nxehjes së linjës apo pajisjes nga gjendja e ftohtë që zgjat maksimumi 30 minuta, kur pasaporta teknike e furrës nuk thotë ndryshe, errësia e tymit është e pranueshme të arrije deri në nivelin 3 të shkallës Ringelmann ose vlerën 60% të opacitetit.

b) Në djegien e lëndëve të djegshme, procesi duhet të kontrollohet në mënyrë të tillë që, megjithë kushtet e vendosura në paragrafin e mësipërm, përmbajtja e SO2, e përcaktuar me kontroll duke matur errësinë e një spoti mbi në filtër nga një mostër e tërhequr sipas shkallës Bacharach nuk duhet të ketë vlerë më të madhe se 4 sipas kësaj shkalle për një nga testet e njëpasnjëshme dhe nivelin 3 për të paktën dy nga tre testet e kryera. Kontrollet për errësinë e tymit sipas shkallës Bacharach nuk duhet të kryhen gjatë nxehjes së linjës nga gjendja e ftohtë.

ANEKS NR. 3

VLERAT E FAKTORËVE TË SHKARKIMEVE PËR PËRCAKTIMIN E SASIVE TË SHKARKUARA ME LLOGARITJE

Lloji i lëndës djegëse	Lloji i kutisë	Kapaciteti termik i furrës	Lëndë të ngurta	SO2	NOx	CO	CxHx	Njësia
Vajra të rëndë dhe të mesëm	Të gjitha	deri 100MW	4	25..S	15.0	1.0	0.7	kg/ton lëndë e djegëshme e djegur
Vajra të lehtë për djegie	Të gjitha	Të gjitha	4	25. S	15.0	1.0	0.9	kg/ton

(+) gaz i lëngët konsiderohet gazi me permbajtje uji që del nga procesi teknologjik.

Gazoil	Të gjitha	Të gjitha	1.42	20. S	5.0	0.71	0.41	kg/ton
Propan-butan	Të gjitha	deri 3 MW > 3 MW	0.45 0.42	0.02 .S 0.02.S	2.4 2.8	0.46 0.37	0.18 0.07	kg/ton
Gaz natyror	Të gjitha	< 0.2 MW 0.2 ~ 5 MW	20 20	2.0. S 2. 0.S	1600 1920	320 320	128 128	kg/106m³ gaz i djegur

ANEKS NR 4

METODAT E MATJES DHE KËRKESAT TEKNIKE NDAJ INSTRUMENTEVE PËR MATJE TË VAZHDUESHME

I. Metodat e analizës së vazhdueshme për matjen e:

A. Ndotësve të ngurtë

absorbim i rrezeve beta

fotometri

B. Shkarkimet e gazta

Parimi i metodësNdotës i ajrit i matur

Spektrometri me rreze infra të kuqeSO2, CO, NOx (NO), Cl-

spetrometri ultravioletSO2, NOx (NO), CO

potenciometriF- and Cl-

kolorimetriH2S

dedektim me jonizim flakehidrokarburet, lëndë organike

djegie katalitikehidrokarburet, lëndë organike

kemilumineshenceNOx (NO)

II. Kërkesat ndaj instrumenteve për matjen e vazhdueshme të shkarkimeve ndotëse

Shkarkimet ndotëse duhet të maten të gjitha me anë instrumentesh që duhet të plotësojnë parametrat teknikë që vijojnë:

a)	Sasia më e vogël e diktuar	deri 2% të intervalit.
b)	Temperatura e mjedisit rrethues	+ 5oC to 35oC ose -10oC deri + 55oC.
c)	Varësia e temperaturës nga pika 0 gjatë një ndryshimi prej 10oC	më pak se ± 2% e intervalit më të ndjeshëm (duhet të kompensohen efektet e jashtme).
d)	Varësia e temperaturës ndjeshmëria (e të dhënave) ndaj një ndryshimi prej 10oC	më pak se ± 3% të intervalit, efektet më të mëdha duhen kompensuar.
e)	Efekti interferues i të gjitha komponentëve në matje	më pak se ± 4% të intervalit më të ndjeshëm.
f)	90% vlerë kohe	nuk duhet të jetë me e madhe se 200 sec. Duke përfshirë edhe kohën e marrjes së mostrës.
g)	Ndryshimet në 0 gjatë intervalit të kontrollit	nuk duhet të jetë me e madhe se ± 2% të intervalit më të ndjeshëm.
h)	Ndryshimet në ndjeshmëri për të njëjtën periudhë kohe	nuk duhet të jetë më e madhe se ± 2% në intervalin më të ndjeshëm.
i)	Marrja e mostrave dhe pajisjet e marrjes së mostrave	të gjitha të projektuara në mënyrë të tillë që të parandalojnë bllokimin me lëndë të ngurta dhe thithjen e substancave që do të maten.
j)	Pika 0 dhe e referimit	duhet të kontrollohet gjatë intervalit me të paktën një regjistrim në pajisjen regjistruese.
k)	Prodhuesi duhet të specifikojë intervalin e kohës për zerimin e aparatit, kalibrimin dhe	

mirëmbajtjen.

ANEKS NR.5

LISTA E INFORMACIONIT TË PANDRYSHUESHËM DHE TË NDRYSHUESHËM TË SHËNIMEVE GJATË FUNKSIONIMIT

1. Identifikimi i burimit të ndotjes

Informacioni konstant:

Të dhëna për operatorin

Numri i identifikimit të operatorit, certifikata personale, emri i aktivitetit dhe adresa e tij, rrethi, prefektura dhe bashkia, rruga, numri, telefoni, faksi, llogari bankare, numri i burimeve të ndotjes.

Të dhëna për burimet e ndotjes

Numri i identifikimit të burimit të ndotjes, kategoria, emri dhe përbërja e burimit, (p.sh. impianti i furrës me seperatorin, teknologjia, minierat, gurore, venddepozitim-mbeturinash, zonë djegie etj.), adresa (rrethi, prefektura dhe bashkia, rruga, numri, telefon, faks, llogari bankare, përfaqësimi statuor dhe numri i burimeve të ndotjes, në rastin kur këto ndryshojnë me identifikimin e operatorit, numrin e regjistrimit në hipotekë, kapacitetin e përgjithshëm ose kapacitetin e prodhimit, personi përgjegjës.

2. Të dhëna për funksionimin teknik

Të dhëna konstante:

Numri i identifikimit të burimit të ndotjes, numri i regjistrimit të teknologjisë, lloji i prodhimit (sipas aneksit nr. 2), emri, prodhuesi, viti i prodhimit dhe lëshimit në punë, periudha e amortizimit moral, regjimi ditor dhe javor, numri i regjistrimit të oxhaqeve ose të daljeve të gazit, numri i njësive të veçanta, zbatimi i normave të shkarkimit.

a) Informacion për furrat dhe njësitë e proceseve të nxehjes pa pasur kontakt të drejtpërdrejtë me substancën teknike.

Informacioni konstant:

Tipi i furrës ose pajisjes, prodhuesi, viti i lëshimit, kapacitetit termik nominal, efikasiteti i furrës ose i pajisjes sipas prodhuesit, lloji i kutisë së zjarrit.

Për furrat për prodhim energji elektrike ose prodhim të kombinuar me energji termike, gjithashtu kapaciteti elektrik i instaluar.

Për furrat dhe pajisjet që djegin lëndë të djegshme të lëngëta dhe të gazta, gjithashtu llojin, kapacitetin dhe mbipresionin e djegësit.

Për furrat dhe pajisjet që djegin në mënyrë të njëkohshme më tepër se një lloj lënde të djegshme, gjithashtu llojin e lëndës së djegshme shtesë dhe kontributin mesatar të saj në kapacitetin termik të linjës.

Informacioni i ndryshueshëm:

Viti, muaji, dita, ora, orët e funksionimit, nxehtësia e prodhuar, përdorimi mesatar i kapacitetit termik.

Për furrat për prodhim energji elektrike ose prodhim të kombinuar me energji termike, gjithashtu kapaciteti elektrik i prodhuar, përdorimi mesatar i kapacitetit elektrik të instaluar.

b) Informacion për proceset e djegies me kontakt të drejtpërdrejtë të produkteve të djegies me substancën teknike.

Informacioni konstant:

Tipi dhe karakteristikat e linjës së djegies, kapaciteti nominal termik, numri i djegësve, tipi, kapacitetit dhe mbipresioni i punës së djegësve, emri i produktit, njësia specifike e produktit, kapaciteti i prodhimit.

Informacioni i ndryshueshëm:

Viti, muaji, dita, ora, orët e funksionimit, sasia e produktit të prodhuar (numri i njësive nominale të produktit në ditën e dhënë, muajin, vitin).

c) Procese të tjera teknike

Informacioni konstant:

Projektimi i produktit, njësia specifike e prodhimit, kapaciteti i prodhimit, nevoja specifike për energji.

Informacioni i ndryshueshëm:

Viti, muaji, dita, ora, orët e funksionimit, sasia e produktit te prodhuar (numri i njësive nominale të produktit në ditën e dhënë, muajin, vitin).

3. Informacion për lëndët e djegshme dhe lëndët e para

a) Informacioni për lëndët e djegshme

Informacioni konstant:

Numri i identifikimit të burimit (burimi), numri i regjistrimit të teknologjisë.

Informacioni i ndryshueshëm:

Viti, muaji, dita, koha, lloji i lëndës së djegshme, harxhimi i lëndës së djegshme, numri i orëve të funksionimit, vetitë e lëndës së djegshme (kapaciteti termik, përmbajtja e ujit në lëndën e thatë ose përmbajtja e hirit dhe e squfurit në mostrën origjinale), shkarkimet e ndotësve (vlerësim përmbledhës).

Për furra dhe linja të tjera që djegin në mënyrë të njëkohshme më shumë se një lloj lënde të djegshme, gjithashtu: llojin e lëndës së djegshme, harxhimin e llojeve të veçanta të lëndës së djegshme, numri i orëve në funksionim, cilësitë e secilës lëndë të djegshme dhe kontributin individual të tyre në kapacitetin termik.

b) Informacioni për lëndët e para

Informacioni konstant:

Numri i identifikimit të burimit, numri i regjistrimit të teknologjisë.

Informacioni i ndryshueshëm:

Viti, muaji, data, koha, emri i lëndës së parë, njësia specifike e lëndës së parë, përmbajtja e ndotësve në lëndën e parë (shkarkimet e prodhimit specifik lidhur me një njësi specifike të lëndës së parë), harxhimi i lëndës së parë në njësi specifike, shkarkimet e ndotësve (vlerësim përmbledhës).

4. Informacion mbi linjat dhe normat e shkarkimit

Informacioni konstant:

Numri i identifikimi të burimit, numri i regjistrimit të teknologjisë. Numri i regjistrimit dhe tipi i pajisjes së ndarjes, numri i njësive, prodhuesi, viti i lëshimit në punë dhe lloji i përbërësve ndotës.

Informacioni i vazhdueshëm:

Numri i regjistrimit të pajisjes ndarëse, koha e regjistrimit, lloji i përbërësve ndotës, efikasiteti aktual, përdorimi në kohë në një interval të dhënë.

5. Informacion mbi oxhakët

Informacion konstant:

Numri i identifikimit të burimit, numri i regjistrimit të teknologjisë. Regjistrimi i numrit të oxhaqeve (ose dalje të tjera), lartësia e oxhaqeve (ose daljeve të tjera në ajër), diametri i brendshëm i oxhakut.

Informacion i ndryshueshëm:

Numri i regjistrimit të oxhakut, sipërfaqja e brendshme në pikën e matjes së shpejtësisë së gazit, temperatura mesatare dhe shpejtësia e gazeve që kalojnë në oxhak (vlerësim përmbledhës).

6. Informacion mbi matjet

Informacioni konstant:

Numri i identifikimit të burimit, numri i regjistrimit të teknologjisë.

Informacioni i ndryshueshëm:

Data, emri i entitetit që kryen një matje të vetme ose matje të vazhdueshme të garantuara, lloji, numri, kushtet dhe vendi i matjes, instrumenti i matjes dhe metoda e përdorur matëse; emri i përbërësve ndotës që maten dhe përqëndrimet e matura të çdo ndotësi në kushtet e referimit, përmbajtjes së oksigjenit në gazin e oxhakut, përqëndrimi dhe fluksi në masë i përbërësve ndotës të përcaktuar.

7. Informacion për avari dhe emergjenca

Informacioni konstant:

Numri i identifikimit të burimit, numri i regjistrimit të teknologjisë. Informacioni i ndryshueshëm:

Data, emri i pajisjes, zgjatja, lloji dhe sasia e shkarkimeve, shkaku i aksidentit, masat e adaptuara, njoftimi i autoriteteve të mbrojtjes së ajrit.

ANEKS NR.6

KËRKESAT E PËRKOHËSHME PËR CILËSINË E LËNDËVE TË DJEGSHME PËR DJEGIE NË TË GJITHA BURIMET E NDOTJES DHE PËR PËRDORIM NGA KONSUMATORI I GJERË

1. Për lëndë të djegshme të vendit:

- Të lëngëta, të ngurta dhe të gazta zbatohen standardet e prodhimeve në fuqi.

2. Për lëndë të djegshme të importit:

- Të lëngëta, të ngurta dhe të gazta zbatohen kërkesat e aneksit nr.7 të vendimet e Këshillit të Ministrave nr.435, datë 12.9.2002 "Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë".